

VENDIM
Nr. 45, datë 7.3.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “RREGULLAVE PËR
KUSHTET E SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT DHE KUSHTET KONTRAKTORE TË
FURNIZIMIT”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 19, pika 1, germa “P” dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.3.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave për kushtet e shërbimit të furnizimit me energji elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit dhe kushtet kontraktore të furnizimit”,

konstatoi se:

- Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e nenit 87 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE përcakton kushtet e furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullave për kushtet e shërbimit të furnizimit me energji elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit dhe kushtet kontraktore të furnizimit”.

2. Deri në hyrjen në fuqi të këtyre rregullave, furnizimi si mundësi e fundit do të kryhet në të njëjtat kushte me shërbimin universal të furnizimit për aq sa është e zbatueshme.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

ANËTAR I BORDIT TË ERE-S
Erjola Sadushi